



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

V E N D I M

Nr. 91 , datë 13 maj 2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PAGESAT E PROKURORËVE PËR PUNËN E KRYER JASHTË ORARIT
ZYRTAR”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 11 pika 3 gërma ç të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 164 pika 8 dhe 189, pika 1, gërma “c” të Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe në nenet 4 dhe 91 të ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale të K.L.P - së,

V E N D O S I :

1. Të miratojë rregulloren për “Për pagesat e Prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar”
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj rregulloreje fillojnë nga data 1 Janar 2019.
3. Të njoftohen me këtë vendim “Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në fletoren zyrtare.

